



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 61-23337/ 15
Kaçanik, 31. 07. 2015

Në bazë të nenit 40.2 (a) të Ligjit 03/L-040 - Për Vetëqeverisje Lokale, Nenit 5.1 (i) të Ligjit Nr. 03/L-068-për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, të Nenit 22 të Ligjit Nr.04/L-032 - për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 02/L-42 –për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, Nenit 13 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2014, Kuvendi i Komunës i Kaçanikut, në mbledhjen e mbajtur me 31 korrik, 2015, mori këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E RREGULLORES PËR TË DREJTAT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E NXËNËSVE TË SHKOLLAVE TË MESME TË LARTA TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT

1. Me këtë vendim, apovohet Rregullorja **01Nr. 61-23337/ 15** me tekstin e mëtejshëm:
Rregullore për të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nxënësve të shkollave të mesme të larta të komunës së Kaçanikut.
2. Me këtë Rregullore përcaktohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nxënësve të shkollave të mesme të larta të komunës së Kaçanikut, shkeljet e detyrave dhe rregullave të nxënësve, masat edukative-disiplinore, procedurat për vërtetimin e përgjegjësisë së nxënësve, zhvillimi i procedurës disiplinore, e drejta për ankesë, përgjegjësia materiale për dëmin e shkaktuar në hapësirat shkollore, si dhe dispozitat e tjera.
3. Rregullorja është hartuar nga Komisioni i formuar me Vendim të Kryetarit të Komunës 01Nr. 16-14616/15 të datës 28.04.2015 -Për hartimin e Rregullores për të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nxënësve të shkollave të mesme të larta të komunës së Kaçanikut, është përmbledhur në gjithsej 11 faqe, me gjithsej 29 nene dhe është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

Me Rregulloren njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe përmes saj njoftohen shkollat relevante, dhe
3. Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi